

NË EMËR TË POPULLIT

GJYKATA SUPREME E KOSOVËS - kolegji i përbërë nga nga gjyqtarët Emine Mustafa, kryetare e kolegjit, Nesrin Lushta dhe Nebojša Boričić, anëtarë, me bashkëpunëtoren profesionale Mirlinda Mejzini, procesmbajtëse, në çështjen penale kundër të pandehurit I.K., për shkak të veprës penale mashtrimi nga neni 335 par.5 lidhur me par.1 të KPK dhe veprës penale shmangia nga tatimi nga neni 313 par.3 lidhur me par.1 të KPK, duke vendosur lidhur me kërkesën për mbrojtje të ligjshmërisë të mbrojtësit të pandehurit I.K., të paraqitur kundër aktvendimit të Gjykatës Themelore në Prishtinë - Departamenti për Krime të Rënda PPR.KR.nr.293/2017 të datës 2.10.2017 dhe aktvendimit të Gjykatës së Apelit të Kosovës, PN1.nr.1825/2017 të datës 10.10.2017, në seancën e kolegjit të mbajtur më datë 8.11.2017, mori këtë:

A K T G J Y K I M

Refuzohet si e pabazuar kërkesa për mbrojtjen e ligjshmërisë e mbrojtësit të pandehurit I.K., e paraqitur kundër aktvendimit të Gjykatës Themelore në Prishtinë - Departamenti për Krime të Rënda PPR.KR.nr.293/2017 të datës 2.10.2017 dhe aktvendimit të Gjykatës së Apelit të Kosovës, PN1.nr.1825/2017 të datës 10.10.2017.

A r s y e t i m

Gjykata Themelore në Prishtinë - Departamenti për Krime të Rënda, me aktvendimin PPR.KR.nr.293/2017 e datës 2.10.2017, të pandehurit I.K., për shkak të veprës penale mashtrimi nga neni 335 par.5 lidhur me par.1 të KPK dhe veprës penale shmangia nga tatimi nga neni 313 par.3 lidhur me par.1 të KPK, i ka vazhduar masën e paraburgimit për 2 (dy) muaj e cila do të llogaritet nga data 4.10.2017 deri më datë 4.12.2017. Masa e paraburgimit i është vazhduar në bazë të nenit 187 par.1 nënpar.1.1 dhe 1.2, pika 1.2.1 dhe 1.2.2 të KPPK-së.

Me aktvendimin Gjykatës së Apelit të Kosovës - Departamenti për Krime të Rënda PN1.nr.1825/2017 e datës 10.10.2017, është refuzuar si e pabazuar ankesa e mbrojtësit të pandehurit dhe është vërtetuar aktvendimin e ankimuar.

Kundër këtyre aktvendimeve, kërkesë për mbrojtje të ligjshmërisë ka ushtruar mbrojtësi i të pandehurit I.K., av. R.D., për shkak të shkeljes së ligjit penal, shkeljes thelbësore të dispozitave

të Kodit të Procedurës Penale nga neni 191 par.2 dhe cenimit flagrant të parimit Kushtetues respektivisht të dispozitës 24 - Barazia para ligjit, me propozim që Gjykata Supreme e Kosovës ta aprovojë kërkesën, t'i anulojë aktvendimet e gjykatës së shkallës së parë dhe ate të shkallës së dytë dhe masën e paraburgimit ta ndërprej ose ta zëvendësoj me ndonjërin nga masat më të buta.

Në kërkesë për mbrojtjen e ligjshmërisë mbrojtësi të pandehurit I.K., kryesisht thekson se prokuroria e shtetit respektivisht PSRKS me vonesë ka dërguar kërkesën për vazhdimin e paraburgimit, se në arsyetimin e aktvendimeve të atakuara ekziston një elaborim politik e asgjë profesionale e ligjore, se kompania është themeluar së bashku me M.Z., i cili e ka mashtruar rëndë kur e ka lut që mos t'i figurojë emri dhe mbriemri i tij pasi që është figurë politike, se nuk ka mashtruar askend nga se kanë kontrata të nënshkruara mbi obligimet reciproke me aplikuesit për sigurimin e lejeve të punës dhe vizave për punësim në Gjermani, se të pandehurit I. i është vazhduar paraburgimi ndërsa me aktvendimin e gjyqtarit të procedurës paraprake bashkëkryerësit tjetër M.Z. i është caktuar masa e arrestit shtëpiak dhe me këtë është shkel parimi kushtetues Barazia para ligjit. Mbrojtësi ka propozuar dorëzimin e dokumentit të udhëtimit dhe deponimin e shumës prej 10.000,00 Eur në emër të dorëzarisë.

Prokurori i Shtetit i Kosovës, me shkresën KMLP.III.nr.81/2017 e datës 7.11.2017, ka propozuar që kërkesa për mbrojtjen e ligjshmërisë e mbrojtësit të pandehurit të refuzohet si e pabazuar.

Gjykata Supreme e Kosovës në seancën e kolegjit, i shqyrtoi shkresat e lëndës, vlerësoi pretendimet e kërkesave, dhe gjeti se:

- kërkesa për mbrojtjen e ligjshmërisë nuk është e bazuar.

Sipas vlerësimit të kësaj Gjykate pretendimet e mësipërme janë të pabazuara ngase në këtë çështje penalo - juridike nga shkresat e çështjes, kryesisht nga provat e mbledhura gjerë më tani rezulton se ekziston dyshimi i bazuar se i pandehuri ka kryer veprat penale për të cilat dyshohet, me çka janë plotësuar kushtet ligjore nga neni 187 par.1 nënpar.1.1 të KPPK, për vazhdimin e paraburgimit, kurse a do të argumentohen këto fakte do të vlerësohet në fazat e mëtejme të procedurës penale.

Kjo Gjykatë vlerëson se ka bazë ligjore për caktimin e paraburgimit konform nenit 187 par.1 nënpar.1.2 pika 1.2.1 të KPPK ngase me lëshimin e të pandehurit në liri ekziston rreziku i fshehjes apo arratisjes me qëllim të shmangies nga përgjegjësia penale duke pasur parasysh faktin se veprat penale për të cilën dyshohet janë të një natyre mjaft të rëndë, e nëse i pandehuri shpallet fajtor, parashihen dënime mjaft të larta, ashtu që i pandehuri po të lihet në liri mund të jet i paaritshëm për organet e ndjekjes dhe do ta pamundësonte zhvillimin e rregullt të procedurës penale, e një gjë e tillë është shumë e lehtë për të pasi që i njejtë është duke jetuar dhe

punuar në shtetin e Gjermanis dhe pas kryerjes se veprave penale edhe ka ikur atje dhe nuk është lajmëruar për një kohë.

Po ashtu, kjo Gjykatë vlerëson se ka bazë ligjore për vazhdimin e paraburgimit konform nenit 187 par.1 nënpar.1.2 pika 1.2.2 të KPPK-së, sepse po të gjendej i pandehuri në liri ekziston rreziku i asgjësimit, fshehjes apo ndryshimit të provave të veprave penale, koordinimit të deklaratave me të pandehurin tjetër, ndikimi në njëri tjetrin apo edhe në dëshmitarët tjerë eventual pasi që të njëjtit ende nuk janë marrë në pyetje nga prokurori, meqenë se hetimet ende nuk kanë përfunduar, rrethana këto të cilat arsyetojnë drojën se me lënien e të pandehurit në liri mund të vijë deri te pengimi i rrjedhës normale të procedurës penale.

Andaj, nga arsyet e mësipërme, kjo gjykatë vlerëson se në rastin konkret nuk ka shkelje thelbësore të dispozitave të procedurës penale, sepse si gjykata e shkallës së parë e po ashtu edhe ajo e shkallës së dytë kanë bërë vlerësimin dhe arsyetimin e duhur, dhe në bazë të vlerësimit të tillë, kanë nxjerrë aktvendimet duke dhënë edhe arsyet të mjaftueshme, të cilat si të drejta i pranon edhe kjo Gjykatë, ndërsa masat tjera të parapara nga neni 173 të KPPK janë të pamjaftueshme për sigurimin e prezencës së të pandehurve në procedurë dhe sigurimin e rrjedhës normale të procedurës penale.

Nga sa u parashtrua dhe në kuptim të nenit 437 të KPPK-së, u vendos si në dispozitiv të këtij aktgjykimi.

GJYKATA SUPREME E KOSOVËS - PRISHTINË

Pml.nr.306/2017, më datë 8.11.2017

Bashkëpunëtorja profesionale,
Mirlinda Mejzini

Kryetare e kolegjit,
Emine Mustafa